



ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt.25.06.2021 nga Operatori Ekonomik, “**Termovision**”Shpk, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-256-2-2-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Refuzohet** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Termovision**”Shpk, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-256-2-2-1, Kundër Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 22.06.2021 të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës.
2. Vërtetohet Njoftimi i Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 22.06.2021, të publikuar përmes platëformës së e-prokurimit dhe të ueb-faqes së KRPP-ës..
3. Autoriteti Kontraktues - Qëndron prapa Njoftimit mbi Vendimin e Aktivitetit të Prokurimit dhe sipas LPP-ës dhe legjislacionit dytësor të Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetimi

Operatori Ekonomik, “**Termovision**”Shpk me date 25.06.2021 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore**” me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-21-256-2-2-1, Kundër Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues të Aktivitetit të Prokurimit të datës 22.06.2021.

Pas analizimit të pretendimit ankimor AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për arsye se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë se: Aktiviteti i prokurimit për kriter ka pasur Tenderin e përgjegjshëm me çmim më të lirë. Andaj ju si OE keni rezultuar me çmim

më të lirë por nuk keni qenë i përgjegjshëm sipas kriterëve të kërkesave të kushteve të dosjes së tenderit të **III.2.4) Kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale.**

Kriteret në dosjen e tenderit për: “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kanë qenë si në vijim:

<p>Operatori Ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme - Një menaxher i projektit të jetë inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë , përvoja e punës minimumi 5 vite pas diplomimit - minimumi dy punëtorë të certifikuar si saldues sipas standardit ISO 9606-1 - minimumi një punëtor instalues i ngrohjes qendrore i trajnuar e certifikuar nga Qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës - minimumi një punëtor i certifikuar BMS SYSTEM i trajnuar dhe certifikuar nga Qendra për aftësim profesional të licencuar nga Republika e Kosovës</p>	<p>Lista me numer të punëtorëve e nënshkruar dhe vulosur nga OE - për menaxherin e projektit - cv, kopja e diplomës universitare, kontrata e punës ose parakontrata, dëshmi mbi përvojën e punës - për salduesit dëshmi kopja e certifikatës ISO 9606-1 - për instaluesin e ngrohjeve qendrore kopjen e certifikates te leshuar nga Qendra per aftesim profesional nga Republika e Kosoves, ne raste se eshte e leshuar jashtë vendit kjo certifikate duhet të noterizohet - për punëtorë BMS SYSTEM - kopjen e certifikates te leshuar nga Qendra per aftesim profesional nga Republika e Kosoves, ne raste se eshte e leshuar jashtë vendit kjo certifikate duhet të noterizohet</p>
--	---

Gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave nga ana e komisionit ka vrejtur se OE “Termovision” Shpk i mungon Çertifikata BMS-Sistem i minimumit të një puntori të certifikuar dhe trajnuar me këtë certifikate që është kërkuar në kushtet e DT. OE ankues kishte një certifikate KNX të minimumit të një puntori të certifikuar dhe trajnuar me këtë certifikate. Komisioni ka kërkuar sqarime nga AK, atëhere Autoriteti Kontraktues duke vrejtur se ka një dallim në mes të këtyre certifikatave kërkuam sqarim nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë të Departamentit të Termoenergjetikës dhe Energji e Ripërtrishme, drejtuar shefit të katedres, Prof.dr.Xhevat Berisha (bashkangjitur gjeni mendimin profesional).

- Mendimi profesional:

Nga: Prof. Dr. Xhevat Berisha

Për: Departamentin e Prokurimit në Komunën e Podujevës

Subjekti: "Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore" - **Certifikata BMS**

Data: 21.04.2021

Bazuar në Kërkesën e adresuar përmes email-it për sqarimin e vlefshmërisë për Certifikatën Hager KNX dhe Certifikatën Keiback&Peter DDC4000 and BMS-Systems, paraqes mendimin profesional si në vijim:

↓ Certifikata Hager – KNX

Certifikata është lëshuar si dokument që dëshmon se kandidati ka qenë në trajnimin dy ditor (11.07.13 deri 12.07.13) në Zagreb, Kroaci, 12.07.2012 dhe i është nënshtruar testit për pjesën teorike dhe praktike. Burimi: <https://www.eltrotec-gmbh.de/ëir-ueber-uns/zertifikate.html>; <https://www.knx.org/knx-en/for-professionals/get-started/get-certified/>

↓ Certifikata Keiback&Peter DDC4000 and BMS-Systems

Certifikata është lëshuar si dokument që dëshmon se kandidati ka qenë në trajnimin në Kompaninë kieback&peter në Berlin, Gjermani, Dhjetor 2012, dhe me sukses kaloi trajnimin për Teknologji për automatizimin e proceseve në ndërtesa. Burimi: <https://www.kieback-peter.com/en/services/training/>

Duke marr parasysh përmbajtjen e këtyre dy Certifikatave mund të konstatoj:

- Certifikata Hager – KNX është e përgjithshme. Kjo nënkupton se nuk ka të specifikuar lëminë e ngushtë të trajnimit të organizuar, edhe pse tek pjesa teorike e provimit janë numëruar disa fusha.
- Certifikata Keiback&Peter DDC4000 and BMS-Systems është e fokusuar në dy module bazë, siç është Moduli DDC4000 dhe Moduli BMS-Systems.

Prandaj bazuar në kushtet në Dosjen e tenderit për Projektin "Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore" me numër të prokurimit: 615-21-256-2-2-1 mund të konkludoj si vijon:

- Certifikata Keiback&Peter DDC4000 and BMS-Systems është më përmbajtësore duke marr parasysh si bazë Modulin BMS-Systems i cili nënkupton:

"Sistem i Menaxhimit të Ndërtesave (BMS) është një sistem kontrolli i bazuar në kompjuter i instaluar në ndërtesa që kontrollon dhe monitoron impiantin kryesor mekanik të ndërtesës p.sh. kaldaja, ventilimi, kondicionimi i ajrit etj. për të ruajtur kushtet optimale të komfortit. Një BMS është më i zakonshmi në një ndërtesë të madhe."

Këto dy Certifikata janë lëshuar jashtë Republikës së Kosovës dhe të njëjtat do të duhej të noterizohen për tu siguruar në origjinalitetin e tyre.

Ju lutem më kontaktoni për informacione dhe komente plotësuese.

Me respekt,

Prof. Dr. Xhevat Berisha
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë
Departamenti: Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtërishme
Kontakti: +38344192-949; xhevat.berisha@uni-pr.edu

- **Gjithashtu të bashkangjitura edhe shkresat përcjellëse për sqarime:**

Kërkesë për sqarime

prokurimi podujeva

Wed 4/21/2021 2:23 PM

Sent Items

To:

Doruntina Sollova;

Kryesuese e Komisionit Vlerësues

1 attachment

Kërkesë për sqarim-Vlerësimi i ofertave në tenderin "Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore" me nr. 615-21-256-2-2-1

Doruntina Sollova

Thu 3/4/2021 11:12 AM

Inbox

Kërkojmë informim lidhur me kërkesën e dërguar me dt: 26/02/2021 nga komisioni për vlerësimin e ofertave në tenderin "Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore" me nr. 615-21-256-2-2-1

prokurimi podujeva

Thu 3/4/2021 10:16 AM

Doruntina Sollova

Fri 2/26/2021 9:00 AM

Inbox

To:

prokurimi podujeva;

Cc:

Xhyldane Nimani;

Kujtim Zhitia;

You forwarded this message on 3/4/2021 10:16 AM.

Të nderuar,

Pas ekzaminimit të të gjitha ofertave në tenderin me nr. 615-21-256-2-2-1 me titull **“Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore”** komisioni për vlerësim kërkon më tepër sqarime për Certifikatën BMS SYSTEM e paraqitur nga OE “Termovision” Sh.P.K. Kërkesë nga pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: ndër të tjera kërkohet **minimum një puntor i certifikuar BMS SYSTEM i trajnuar dhe certifikuar nga Qendra për aftësim profesional të licensuar nga Republika e Kosovës.**

Komisioni:

Doruntina Sollova
Xhyfidane Nimani
Kujtim Zhitia

Prof. Dr. Xhevat BERISHA <xhevat.berisha@uni-pr.edu>

Wed 4/21/2021 10:41 AM

Inbox

1 attachment

Pershendetje,

Bazuar ne Kerkesen tuaj eshte bashkangjitur dokumenti: Departamenti i Prokurimit në Komunën e Podujevës_21.04.2021.

Me respekt,

prokurimi podujeva

Fri 4/16/2021 9:47 AM

Prof. Dr. Xhevat BERISHA <xhevat.berisha@uni-pr.edu>

Fri 4/16/2021 8:37 AM

Inbox

Pershendetje,

Bazuar ne Kerkesen e juaj une do te mundohem qe deri Marten ta keni pergjegjien.

Me respekt,

prokurimi podujeva

Thu 4/15/2021 3:51 PM

Sent Items

1 attachment

I ndëruari, z.Berisha

-Jemi Departamenti i Prokurimit në Komunën e Podujevës, po ju drejtohem përmes juve, Fakulteti Teknik-Departamenti Gjegjës, që mundësishtë të na jepni sqarimin apo vlerësimin e Çertifikatës BMS-Sistem.

Dy OE që kanë aplikuar në komunën e Podujevës përmes sistemit të e-prokurimit në projektin "Renovimi dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore" me nr. të prokurimit: 615-21-256-2-2-1. Dhe përmes kushteve që kanë kërkuar zyra e prokurimit një ndër to është edhe: Të jetë i licencuar me **Çertifikatën e BMS**.

Të ndëruar gjeni të bashkangjitur të dy Çertifikatat njeri operatorë ka Çertifikat me emer KNX ndërsa operatori tjetër ka Çertifikatë BMS.

-Ju lutem që pres nga ju gjegjësisht Fakulteti Teknik-Departamenti gjegjës, një vlerësim dhe mendimin adekuat profesional për vlerësimin e këtyre Çertifikatave se a janë të ngjashme në thelb pasi janë kompani të ndryshme që kanë lëshuar, apo nuk janë dhe nëse nuk janë të njëjta, atëherë cila nga këto dy Çertifikata është adekuate sipas kërkesës së zyrës tonë të prokurimit në Komunën e Podujevës.

Me respekt!

Zyra e Prokurimit

Komuna e Podujevës

- Bashkangjitur, Çertifikatat e dy OE. "Termovision" Shpk - Çertifikimi me **Hager KNX** dhe OE. "B.Engineering" – Çertifikimi me **BMS-Sistem** i kërkuar në DT.

CERTIFICATE

Hajriz Mustafa

Company

TrePharm

Successfully passed the training for the

kieback&peter

Technology for Building Automation

DDC4000 and BMS-Systems



General Manager of Export Dept.
Date: December 2012

kieback&peter

Technologie für Gebäude-Automation
Kieback&Peter GmbH & Co. KG
Tempelhofer Weg 50
D-12347 Berlin

CERTIFICATE

Alban Mehmeti

Company


TrePharm

Successfully passed the training for the

kieback&peter

Technology for Building Automation

DDC4000 and BMS-Systems



General Manager of Export Dept.
Date: December 2012

kieback&peter

Technology for Building Automation
Kieback&Peter GmbH & Co. KG
Tempelhofer Weg 90
D-12347 Berlin

hager



Zertifikat

Alush Sejdiu

geboren am 23.06.1956

in Prishtina

hat die

KNX-Schulung mit Abschlussprüfung

erfolgreich bestanden.

Die KNX-Schulung wurde durch die oben genannte zertifizierte Schulungsstätte vom 11.07.13 bis einschließlich 12.07.13 veranstaltet. Die Prüfung war aufgeteilt in:

- **Theoretische Prüfung:** erstellt auf Basis der einheitlichen KNX-Schulungsunterlagen (KNX Systemargumente, KNX Kommunikation, KNX TP1 Topologie, KNX TP1 Telegramm, KNX Powerline, KNX Bussteilnehmer, KNX TP1 Installation, Projektierung ETS, Inbetriebnahme ETS, Diagnose & Fehlersuche ETS)
- **Praktische Prüfung:** Projektierung, Inbetriebnahme und Diagnose eines vorgegebenen KNX-Projektes

Zagreb, 12.07.2013

Yves Peters
Schulungsleiter

Martin Heib
KNX-zertifizierter Ausbilder

AK në bazë të kriterëve të kushteve të DT, parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim, nuk e disponon çertifikimin BMS-Sistem e kërkuar minimumi i një puntori gjithashtu edhe verifikimet dhe mendimet e sqarimet shtesë, nuk i plotësojn kriteret për dhënje të kontratës.

Nga se u cek më lartë, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në institucionet tjera kompetente.

Nr. 14-370/03-005 2443/21
Podujevë,
30.06.2021



Menaxheri ZP
Rasim Fejza